




A2023050360054975914



**AKT THEMELIMI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ART 2023" SH.P.K**

Sot, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtarë në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Muhamet Gjollesha, Pall. Moskat, shk 3, ap 14", u paraqit personalisht:

THEMELUESE: Shoqëria "SEAN" SH.P.K, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11829504Q, me adresë Lagjja Nr. 16, Rr. Hyen Kertusha, Objekti Big Bar, Kati 4, përfaqësuar nga Administratorja **Maria Mino**, atësia Nikolin, amësia Sirela, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, lindur më 14/08/1994, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038682349 dhe nr. personal J45814092M.

Baza Ligjore: Ligi nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare", i ndryshuar Neni 62, pika 1, gërmë "I" të Ligjt nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Rrethanat për hartimin e aktit notarial:

Personat me identitetin e mësipërm shprehën vullnetin e tyre të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqërítë tregtare, si dhe do të referohet për mbarëvajtjen e saj në Aktin e Themelimit dhe Statutit të krijuar nëpërmjet këtij akti.

**I.
Krijimi**

I.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**ART 2023**" SH.P.K (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), themelohet në bazë të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregetarët dhe Shoqërítë Tregtare".

**II.
Objekti**

II.1 Objekt i aktivitetit të Shoqërisë është Aktivitet ne fushen e ndertimit, e cila konsiston:

Investim dhe menaxhim ne fushen e veprimtarise ndertimore, per ndertimin e cdo lloj objekti dhe per kryerjen e cdo lloj vepre apo punimi me karakter publik apo që do ti sherbeje interesit publik apo me karakter privat, te natyres civile, industriale, turistike, bujqesore, qendra biznesi, hotele, bar, restorante, investim dhe menaxhim per ndertimin e urave, celjen dhe perfundimin e rrugeve te reja, celjen dhe ushtrimin e aktivitetit te agjensive imobilare, investim, menaxhim dhe ndertime mbrojtese e punime sistemimi kunder gerryerjeve lumore, liqenore, import-eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te material eve te gjithellojshem ndertimore, investime dhe sipermarrje ndertimore per ndertimin dhe menaxhimin e hidrocentraleve dhe TEC-ve, me qellim per te realizuar prodhimin, transmetimin dhe shperndarje te energjise elektrike, si nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj dhe TEC-eve dhe rehabilitimit te tyre, sherbime te ndryshme dhe punime sherbimesh ne te gjitha fushat sipas shperndarjes se energjise, ndertime per N/stacionet, kabinat e trasformatoreve, linjat e TN te ulet, te mesem, te larte, dhe shperndarjen e energjise, eksport, import, shitblerje dhe prodhim te energjise elektrike, ndertime, punime dhe vepra te cfareolloji që kane te bejne ndertimin dhe menaxhimin e sherbimeve dhe rrjetit te ujesellesave dhe kanalizimeve, si mirembajtje, riparim, permiresimin e rrjetit ekzistues te 2 ujesellesit, hapjen e rrjeteve te reja apo te pikave dhe linjave te reja te furnizimit apo te shperndarjes se ujesellesit, godinave te administrates, linjave, nenstacioneve, kabinave te ujesellesit, import, eksport, shitje,



A2023050360054975924

prodhim dhe shperndarje te ujrave etj, import, eksport dhe tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, pajisjeve apo makinerive te nevojshme dhe qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit sipas objektit te veprimitarise, artikujve ushqimore, bjegtorale, buqesore dhe te cdo lloj malli tjeter te lejuar per tregtim, marreveshje kontraktore me persona juridike vendas dhe te huaj per zgjerimin apo koperimin e aktivitetit etj. Projektim, zbatim, ne fushen e ndertimeve civile, turistike, buqesore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastruktura, rikonstruksione civile, mirembajtje, zhvillim dekor i njedise urbane.

Prodhim, perpunim i materialeve te ndertimit, transportim, tregtim me shumice dhe pakice, Import dhe eksport dhe magazinim dhe shperndarja e materialeve te ndertimit.

Organizimi dhe pajisja e panaireve dhe ekspozitave te sherbimeve, reklamave dhe marketingu.

Te zhvilloje cdo veprimitari dhe aktivitet tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Dhenie te ambjenteve me qera.

II.2 Gjithashtu, Shoqëria mund te kryejë çdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

II.3 Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimitarise se saj te rregullt ekonomik.

III.

Zyra qëndrore

1. III.1 Zyra qëndrore e Shoqërisë është në adresën: Apartament me sipërfaqe ndertimore 162 m², i perbere me 3+1, i ndodhur ne objektin "Godine banimi dhe sherbimi 7 dhe 12 kate, me 2 kate parkim nentoke", i ndertuar sipas lejes se ndertimit ne. prot. H-30926/9, miratuar me Vendim te kryetarit te Bashkise me date 10/04/2019.

III.2 Shoqëria mund te hapë zyra dhe/ose të kryejë aktivitet në vende të tjera si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të organit kompetent ose vendimmarrës.

IV.

Kohëzgjatja

IV.1 Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

V.

Kapitali Themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

V.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100'000 Lekë (njëqind mijë Lekë), i perbere nga 1 (nje) kuote, e zotëruar nga një ortak .

V.2 I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar në para nga ortaku i Shoqërisë.

V.3 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme midis ortakëve në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar.

V.4 Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tyre te nënshkruar në kapitalin e Shoqërisë.

V.5 Përqindja e pjesëmarries së secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë është:

Shoqëria "SEAN" SH.P.K, me NUIS M11829504Q, zotëruese e 100 % të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 100'000 leke (njëqind mijë leke);



A2023050360054975924

V.6 Ortaku kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë në raport me pjesëmarrien e tyre në kapitalin themeltar, domethene fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

V.7 Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë; Kapitali i shoqërisë do të hidhet në Bankë pasi te dali NIPT i shoqërisë.

V.8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

VI. Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve te percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

VII. Administrimi



A2023050360054975924

VII.1 Shoqëria administrohet nga një, dy ose më shumë administratorë, persona fizikë të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas Statutit te Shoqerisë.

VII.2 Veprimet e administrimit të Shoqërisë në rast të dy administratorëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga të paktën njëri prej tyre dhe në rast të dy ose më shumë administratorëve veprimet konsiderohen të vlefshme nëse nënshkruhen të paktën nga 2 prej administratorëve të Shoqërisë.

VII.3 Administratori emerohet për një periudhë 5 vjecare dhe mund të riemërohet, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem

VII.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet: **Maria Mino**, e cila ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj.

VII.5 Administratori shkarkohet nga detyra në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

VII.6 Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

VII.7 Administratori eshte perjegjes ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

VIII.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:

Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Pjesmarjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja përgjithshme e Asamblese dhe organet e tjera te shoqerise.
- Te heqe dore nga shoqeria (heqja dore nga shoqeria nuk i liron ortaket nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise).
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaquesuesit te tij ose vete.
- Te emeroje dhe te shkarkoj perfaquesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuiditoret.

Ortaku ka keto detyrime kryesore:

- Te depozitoj kuoten e tij dhe kuoten suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- T'i japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ka detyrimin qe nese heq dore nga shoqeria ti njoftoj vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes sipas nenit .
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

IX.

Viti ushtrimor

IX.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përashtimi, viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Registrin Tregetar dhe përfundon më 31 Dhjetor të vitit në vazhdim.



A2023050360054975924

X.

Mbyllja e Shoqerise:

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortaku kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e kriujimit te shoqerise (kontrata). Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga nen 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Në këtë rast Asambleja e përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

XI.

Kur shoqeria likuidohet:

Asambleja e ortakut emeron likuiditorin, dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likuidimit.

Komisioni i Likuidimit perbehet nga nje ose tre anetare.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakut.

Likuidimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likuiduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likuditoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe, secila njëloj e vlefshme.

Nënshkruar nga Ortakët Themelues sot më datë 24/02/2023.

ORTAKU THEMELUES

SHOQËRIA "SEAN" SH.P.K
përfaqësuar nga Administratorja
MARIA MINO





A2023050360054975924

Në zbatim të gjermës "I" të pikës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", ku parashikohet: *Kompetencat e noterit/es: I) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare*, unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Aktit të Themelimit të shoqërisë.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tyre nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germane "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti notarial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
MARGALINA DAUTI

